

**AKT THEMELIMI**  
**i shoqërise me përgjegjësi të kufizuar**  
**"I.T.E GRUP" Sh.P.K.**



Në Tiranë, sot, më 16.01.2001, personat e mëposhtëm:

1. **Sokol Zotka**, i biri i Jonuzit, lindur në Tirane më 07.05.1956 dhe banues në Tirane, në adresën: Bulv. "Bajram Curri", pall.35, shk. 1, ap.6;
2. **Xhaferr Shabani**, i biri i Ibrahimit, lindur në Tirane më 14.10.1951 dhe banuese në Tirane, në adresën: Sheshi "Avni Rustemi", nr.13/3;

hartojnë Aktin e Themelimit të shoqërise me përgjegjësi të kufizuar "**I.T.E Grup**" sh.p.k. me këtë përbajtje:

**Neni 1**

Shoqëria krijohet dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht, por jo ekskluzivisht, me ligjin nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe ligjin nr.7667, datë 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare" si dhe me dispozitat e Statutit të Shoqërisë që i bashkëngjitet këtij Akti Themelimi.

**Neni 2**

Emërtimi i Shoqërisë është "**I.T.E Grup**" Sh.P.K.

**Neni 3**

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën: Rruga "Perlat Rexhepi.", pall. 10-katesh perballë Drejtorese se Gardes. Transferimi i selisë së Shoqërisë në një adresë tjeter bëhet me miratimin e ortakëve që zoterojnë të paktën 3/4 e pjesëve të kapitalit themeltar.

**Neni 4**

Shoqëria ka si objekt te veprimtarise se saj:

Importimin, eksportimin dhe tregtimin e të gjitha llojeve të mallrave, materialeve, makinerive, pajisjeve dhe impianteve te ndryshme, të karakterit elektrik, elektroshtepiak, elektronik, te telekomunikacionit, te destinuara per objekte civile dhe industriale në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Prodhimin e pajisjeve dhe makinerive te permendura me siper.

Kryerjen e veprimtarive te shërbimit e riparimit të karakterit elektrik, elektronik, te telekomunikacionit e të llojeve të tjera.

Projektimin dhe zbatimin e projekteve, dhënien e konsulencës, asistencës teknike dhe kryerjen e shërbimeve në lidhje me veprimtaritë e mësipërme.



### Neni 5

Shoqëria do te ushtrojë veprimtarine e saj per një afat te pakufizuar kohe.

### Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njeqind mijë) lekë. Ky kapital përbëhet nga kontributet e mëposhtme:

1. **Sokol Zotkaj** kontribuon në shumën 60.000 (gjashtedhjet mijë) lekë.
2. **Xhaferr Shabani** kontribuon në shumën 40.000 (dyzet mijë) lekë.

### Neni 7

Kapitali themeltar i Shoqërisë është i ndarë në 100 (njeqind) pjesë me vlerë nominale 1000 (njëmijë) lekë secila, të renditura sipas numrit të serisë nga 1 në 100.

Në bazë të kontributeve të lartpermendura :

1. **Sokol Zotkaj** ka 60 (gjashtedhjet) pjesë të kapitalit themeltar të renditura nga numri i serisë 1 (nje) deri në numrin e serisë 60 (gjashtedhjet).
  2. **Xhaferr Shabani**, ka 40 (dyzet) pjesë të kapitalit themeltar të renditura nga numri i serisë 61 (gjashtedhjet e nje) deri në numrin e serisë 100 (njeqind).
- Pjeset e kapitali themeltar të shoqërise janë tërësisht të nënshkruara dhe të shlyera nga ortakët.

### Neni 8

Ortakët kanë derdhur shumën në të holla që përbën kapitalin themeltar të shoqërise në Bankë, në një llogari të hapur në emër të Shoqërisë në formim e sipër.

### Neni 9

Administrimi i Shoqërise do të realizohet nga administratori / administratorët e saj. Administratori i parë i zgjedhur është zoti **Sokol Zotkaj**, i biri i Jonuzit, lindur në Tirane, më 07.05.1956 dhe banues në Tirane, në adresën: Bulv. "Bajram Curri", pall.35, shk.1, ap.6. Zotit **Sokol Zotkaj** i jepen kompetenca te plota, të cilat ai i pranon, për të kryer të gjitha formalitetet e themelimit të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

### Neni 10

Ky Akt Themelimi u hartua sot, më 16.01.2001, në Tiranë, në katër kopje origjinale, në gjuhën shqipe, duke pasur të gjithë fuqi të barabartë ligjore.

## O R T A K E T

Sokol Zotkaj

*Sokol Zotkaj  
fikli*

Xhaferr Shabani

*Xhafer Shabani  
DZL*



## S T A T U T

**i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar  
" I.T.E.GRUP " Sh.P.K.**

Në Tiranë, sot, më 16.01.2001, personat e mëposhtëm:

1. **Sokol Zotkaj**, i biri i Jonuzit, lindur në Tiranë më 07.05.1956 dhe banues në Tiranë, në adresën: Bulv. "Bajram Curri", pall. 35, shk. 1, ap. 6;

2. **Xhafer Shabani**, i biri i Ibrahimit, lindur në Tiranë më 14.10.1951 dhe banuese në Tiranë, në adresën: Sheshi "Avni Rustemi", nr. 13/3;

pasi kanë vendosur krijimin, konform ligjit, te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "**I.T.E Grup**" sh.p.k., hartoje Statutin e Shoqërise me kete permbajtje:

### **K R E U I** **FORMA, EMERTIMI I SHOQERISE, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA**

#### **Neni 1**

#### **Forma**

Shoqëria krijohet dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht, por jo ekskluzivisht, me ligjin nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqërítë tregtare" dhe ligjin nr. 7667, datë 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare" si dhe me dispozitat e këtij Statuti.

#### **Neni 2**

#### **Emërtimi i Shoqërisë**

Emri i Shoqërisë është "**I.T.E Grup**" Sh.P.K.

#### **Neni 3**

#### **Objekti i Shoqërisë**

Shoqëria ka si objekt te veprimtarise se saj:


Importimin, eksportimin dhe tregtimin e të gjitha llojeve të mallrave, materialeve, makinerive, pajisjeve dhe impianteve te ndryshme, të karakterit elektrik, elektroshtepiak, elektronik, te telekomunikacionit, te destinuara per objekte civile dhe industriale në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Prodhimin e pajisjeve dhe makinerive te permendura me siper.

Kryerjen e veprimtarive te shërbimit e riparimit të karakterit elektrik, elektronik, te telekomunikacionit e të llojeve të tjera.

*Safeti*

*[Signature]*



Projektimin dhe zbatimin e projekteve, dhënien e konsulencës, asistences teknike dhe kryerjen e shërbimeve në lidhje me veprimtaritë e mësipërme.

#### Neni 4

##### Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tirane, ne adresën: Rruga "Perlat Rexhepi.", pall. 10-katesh perballë Drejtorisë se Gardes. Transferimi i selisë së Shoqërisë në një adresë tjeter bëhet me miratimin e ortakëve që zoterojnë të paktën 3/4 e pjesëve të kapitalit themeltar.

#### Neni 5

##### Kohëzgjatja

Shoqëria do te ushtrojë veprimtarine e saj per një afat te pakufizuar kohe.

#### K R E U II

### KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

#### Neni 6

##### Kapitali i Shoqerise

Kapitali i Shoqerise është 100.000 (njeqind mijë) lekë.

Ai është ndarë në 100 (njeqind) pjesë plotësish të shlyera me vlerë 1.000 (nje mijë) lekë secila, të renditura sipas numrit të serisë nga 1 (nje) deri në 100 (njeqind).

Fondet që rrjedhin nga shlyerja e pjesëve janë depozituar në Bankë, për llogari të Shoqërisë ne krijim e siper.

Shoqëria mund të zmadhojë ose zvogëlojë kapitalin e saj. Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit vendoset nga Asambleja e Ortakëve me shumicën e ortakëve të pranishëm ose të përfaqësuar, që zoterojnë të paktën 3/4 e pjesëve të kapitalit themeltar. Zvogëlimi i kapitalit i prek të gjithë ortakët në proporsion me pjeset e tyre.

#### Neni 7

##### Kontributet

Kapitali themeltar përbëhet nga kontributet e mëposhtme :

- Sokol Zotka** kontribuon në shumën 60.000 (gjashtdhjet mijë) lekë.
- Xhaferri Shabani** kontribuon në shumën 40.000 (dyzet mijë) lekë.

#### Neni 8

##### Pjesët e kapitalit themeltar

Në bazë të kontributeve të sipërpermendura:

1. Sokol Zotka ka 60 (gjashtedhjet) pjesë të kapitalit themeltar të renditura nga numri i serisë 1 (nje) deri në numrin e serisë 60 (gjashtedhjet).
2. Xhafer Shabani ka 40 (dyzet) pjesë të kapitalit themeltar të renditura nga numri i serisë 61 (gjashtedhjet e nje) deri në numrin e serisë 100 (njeqind).  
Të gjitha pjesët që formojnë kapitalin themeltar janë nënshkruar dhe shlyer plotësisht nga ortakët.

#### Neni 9

#### Lënia dhe transferimi i pjesëve të kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve dhe ne rrugë trashëgimie.

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen të tretëve me kushte jo më të favorshme se ato me të cilat ju janë ofruar më parë ortakëve të tjera.

### K R E U III

### MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQERISE

#### Neni 10

#### Ortakët dhe Asambleja e Ortakëve

Ortakët e Shoqërisë përballojnë humbjet e saj deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e Asamblesë dhe disponon një numër votash të barabartë me pjesët e kapitalit themeltar që ai zoteron. Në ushtrimin e të drejtës së tij për të marrë pjesë në vendimet kolektive, çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një ortak tjetër, nga bashkëshorti ose nga një person tjetër i zgjedhur prej tij.

Mbledhja e Asamblesë mund të kërkohet nga një ose disa ortakë që zoterojnë mbi 1/10 e pjesëve të kapitalit themeltar, nga administratori, nga ekspertët kontabël të autorizuar, po që se ka të tillë, ose nga likuidatori. Mbledhja e asamblesë thirret nga administratori.

Sipas rëndësise së vendimeve, mbledhja e Asamblesë mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme. Asambleja e zakonshme vodos për çështje të tilla si emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likuiduesve, miratimi i raporteve të administrimit dhe kontrollit, miratimi i llogarive vjetore dhe ndarja e fitimit etj. Asambleja e jashtëzakonshme vodos për çështje të tilla si ndryshimet e statutit, zvogëlimi i kapitalit themeltar, transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretët, zgjatja e kohës së veprimitarisë së shoqërisë apo likujdimi i saj, shndërrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera etj.

Asambleja e zakonshme në mbledhjen e parë mund të marrë vendime të vlefshme në qoftë se janë të pranishëm ose të përfaqësuar një numër ortakësh që zoterojnë mbi 1/2 e pjesëve të kapitalit themeltar dhe vendimet merren nga ortakët që përfaqësojnë mbi 1/2 e pjesëve të kapitalit themeltar të pranishëm ose të përfaqësuar. Në qoftë se mbledhja e parë e

  
Asamblësë së zakonshme nuk realizohet, thirret mbledhja e dytë e cila mund të marrë vendime të vlefshme, pavarësisht se sa pjesë të kapitalit themeltar zotërojnë ortakët e pranishëm ose të përfaqësuar dhe vendimet merren nga ortakët që përfaqësojnë mbi 1/2 e pjesëve të kapitalit themeltar.

Asambleja e jashtëzakonshme kërkon kushte prezence ose përfaqësimi të njëjta me ato të Asamblësë së zakonshme si në mbledhjen e parë ashtu edhe në mbledhjen e dytë, por vendimet merren nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 3/4 e pjesëve të kapitalit themeltar.

### **Neni 11 Administrimi**

Shoqëria administrohet nga një ose disa administratorë. Administratori duhet të jetë person fizik dhe mund të jetë ose jo ortak në Shoqëri.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me miratimin e shumicës së ortakëve që zotërojnë mbi 1/2 e pjesëve të kapitalit themeltar. Emërimi i tij bëhet për një kohëzgjatje të barabartë me periudhën e ekzistencës së vetë shoqërisë.

Administratori eshte perjegjes individualisht ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Administratori i parë i zgjedhur është zoti **Sokol Zotka**, i biri i Jonuzit, lindur në Tirane, më më 07.05.1956 dhe banues në Tirane, në adresën: Bulv. "Bajram Curri", pall.35, shk.1, ap.6.

Në marrëdhënie me ortakët dhe të tretët administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë dhe në emër të saj, nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e Shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që ligji dhe statuti ua jepin shprehimisht ortakëve.

### **Neni 12 Ekspertët kontabël të autorizuar**

Në rast nevoje ose nëse e kërkon ligji, kontrolli i shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabël i autorizuar, i emëruar për tre vite financiare me mundësi rizgjedhje nga ortakët që përfaqësojnë mbi 1/2 e kapitalit themeltar.

Shkarkimi i ekspertit kontabël të autorizuar vendoset në të njëjtat kondita si emërimi, në rast se vërehen gabime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

## **K R E U IV VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE**

### **Neni 13**

#### **Viti finanziar, llogaritë vjetore**

Çdo vit finanziar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.





Mbas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së pjesëve të kapitalit themeltar tek kontribuesit përkatës, likuiduesi ndan kapitalet e mbetura ndërmjet ortakëve proporcionalisht me pjesët që ata zoterojnë në kapitalin themeltar.

## K R E U VI DISPOZITA TE FUNDIT

### Neni 18

#### Shndërrimi i shoqërisë

Shndërrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri kolektive ose në shoqëri komandite mund të kryhet vetëm me miratimin unanim të ortakëve, ndërsa shndërrimi në shoqëri anonime, me miratimin e ortakëve që zoterojnë të paktën 3/4 e pjesëve të kapitalit themeltar.

### Neni 19

#### Mosmarrëveshjet

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit ndërmjet ortakëve, ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, do t'i paraqiten për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Tiranë.

### Neni 20

Ky Statut është hartuar më 16.01.2001, në Tiranë, në katër kopje në original, në gjuhën shqipe, duke patur të gjitha tekstet fuqi të njëjtë ligjore.

## O R T A K E T

Sokol Zotka

Xhafer Shabani